

V E N D I M
Nr.450, datë 16.9.1999

PËR REGJIMIN E EKSPORT-IMPORTIT TË MALLRAVE NGA DHE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës me propozimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe të Ministrisë së Financave,

KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D O S I :

1.Importi i mallrave në Republikën e Shqipërisë është i lirë, me përjashtim të mallrave, që me akt ligjor e nënligjor ndalohen të futen në Republikën e Shqipërisë ose që importi i tyre, i nënshtrohet një regjimi të veçantë, të përcaktuar me akte normative të veçanta.

2. Eksporti i mallrave nga Republika e Shqipërisë është i lirë, me përjashtim të mallrave që me akte ligjore e nënligjore ndalohen të nxirren nga Republika e Shqipërisë ose që eksporti i tyre i nënshtrohet një regjimi të veçantë, të përcaktuar me akte normative të veçanta.

3.Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.360, datë 10.7.1995, ndryshuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.415, datë 7.8.1995; nr.121, datë 12.2.1996; nr.711, datë 21.10.1996, si dhe pikat 1, 2 dhe 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.200, datë 2.5.1997; nr.98, datë 4.2.1998 dhe nr.321, datë 23.5.1998, si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko